

VENDIM
Nr. 179, datë 8.3.2017

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 561, DATË 16.8.2006, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PAGAT SIPAS GRADAVE PËR PUNONJËSIT, OFICERË DHE
NËNOFICERË, TË GARDËS
SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të nenit 34, të ligjit nr. 8869, datë 22.5.2003, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr. 1, “Paga bazë sipas gradës për punonjësit, oficerë dhe nënoficerë, të Gardës së Republikës së Shqipërisë”, e përmendur në pikën 1, të vendimit nr. 561, datë 16.8.2006, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2017, të përballohen nga fondet e miratuara në ligjin nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, për politikën e reja të pagave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrihet efektet financiare nga data 1 mars 2017.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LIDHJA NR. 1
PAGA BAZË SIPAS GRADËS, PËR PUNONJËSIT, OFICERË DHE NËNOFICERË,
TË GARDËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Roli i punonjësve sipas gradave		Grada	Paga bazë për gradë
Për punonjësit oficerë	madhor	Gjeneral garde	118500
	i lartë	Kolonel	106000
		Nënkolonel	93700
		Major	80700
	i mesëm	Kapiten	69000
		Nënkapiten	65400
	i ulët	Toger	62100
		Nëntoger	59300
Për punonjësit nënoficerë	madhor	Kryekapter	51000
	i lartë	Kapter	48400
		Kapter Shtabi	47250
		Kapter mjeshtër	46200
	i mesëm	Kapter i parë	45700
		Kapter i dytë	45150
		Kapter i tretë	44600
	i ulët	Kapter i katërt	43700
		Rreshter	42500